



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: N.P.SH."Valiant"
Numri Unik Identifikues: 811464346
Pronar: Valon Maloku dhe Mrika Kotorri
Emri i OSHMA-së: 1st Channel
Adresa: Rr/. Tahir Zajmi (Ish-KosovaTex)



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio-vizuele me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes 1st Channel, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. 1st Channel është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio-vizuale (OSHMA), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 17 janar 2013, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA 1st Channel.
3. Me datën 17 janar 2023, ka skaduar afati i licencës për 1st Channel ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 9 nëntor 2022, 1st Channel ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.
5. Për shkak të pamundësisë së vendimarrjes së Komisionit të Pavarur të Mediave për arsye të mungesës së kuorunit, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e 1st Channel, nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.

Arsyetimi


6. Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson: *"Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e*

ofruesit të shërbimit medial audio-vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,

7. Komisioni konstaton se, 1st Channel përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio-vizuele me transmetim përmes operatorit të shpërndarjes.
8. Komisioni vlerëson se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, audio-vizuel 1st Channel të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
9. Komisioni konstaton se 1st Channel ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
10. Komisioni konstaton se sipas verifikimit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), përmes të dhënave mbi bizneset që mund të shihen në faqen e internetit të kësaj agjencie, nuk ka ndryshim të pronësisë së 1st Channel.
11. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së 1st Channel është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së 1st Channel plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut.

Vendim

12. Komisioni në takimin e tij të datës 13 shtator 2023, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së 1st Channel, për të ushtruar veprimtarin si ofrues i shërbimeve mediale audio-vizuale, me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes në Republikën e Kosovës.
13. Licenca e KPM-së për OSHMA 1st Channel do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 17 janar 2023.
14. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, të OSHMA 1st Channel mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
15. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



13.09.2023

datë